

**Punimet në nënstacion, ja zonat pa energji**

Energjia elektrike do të mungojë sërish sot në disa zona periferike të kryeqytetit. Burime pranë operatorit të sistemit të transmetimit shprehën se si pasojë e punimeve në linjën 104/1, nuk do të ketë drita në disa zona periferike. Konkretisht zona e Saukut të poshtëm, Saukut të sipërm dhe përreth liqenit artificial nuk do të kenë energji elektrike nga ora 09:00 deri në orën 15:00. Herë pas here, OST dhe OSSH kryejnë punime në nënstacione të ndryshme elektrike apo në linjat e tensionit të lartë,

punime të cilat shoqërohen me ndërprerjen e energjisë elektrike. Ndërkohë gjatë këtyre ditëve, me uljen e temperaturave, kërkesa për energji është rritur ndjeshëm. Sipas të dhënave nga korporata elektroenergjetike, konsumi i energjisë ka aritur në 22.2 milionë kilovat orë, nga kjo gati 20.3 milionë kilovat orë është prodhim vendas. Krijta e prodhimit vendas të energjisë ka ardhur si pasojë e situatës së mirë hidrike në kaskadën e Drinit.



**Projekti me Bankën e Shqipërisë**



Fatos Ibrahimi

**Banka Botërore ndihmë për sektorin financiar**

Banka Botërore në sajë të një projekti të saj po ndihmon në modernizimin e sektorit financiar në vend. Më shumë se njëqind ekspertë bankarë nga institucionet publike dhe nga bankat tregtare, po punojnë së bashku për hartimin e rregullave dhe të praktikave, për një sistem financiar modern dhe eficient në Shqipëri. Këta ekspertë punojnë nën drejtimin e "SPI Albania", një partneritet për modernizimin e sektorit financiar, i krijuar në vitin 2008 nga Banka e Shqipërisë dhe nga Shoqata Shqiptare e Bankave, me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit të ekspertëve shqiptarë, gjatë procesit të përgatitjes për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Rajoni i Pulias dhe Programi i Konvergencës i Bankës Botërore (i financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës Italiane) kanë dhënë një mbështetje financiare dhe teknike të çmuar për fillimin e këtij partneriteti. Takimit tremujor të Komitetit të SPI-së drejtohen nga Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë, Fatos Ibrahimi. "Së bashku me kolegë nga ministri dhe agjenci të tjera, si dhe nga Shoqata Shqiptare e Bankave, ne shqyrtojmë progresin e ekspertëve tanë në përgatitjen e propozimeve për reforma. Në çdo diskutim, ne zhvillojmë biseda informale mbi gjetjet e ekspertëve dhe përiqemi t'i ndihmojmë ata në arritjen e konkluzioneve, të cilat do të kenë një impact praktik mbi jetën e qytetarëve shqiptarë", është shprehur ai. Sipas tij, SPI Albania ka krijuar një hapësirë të re, ku ekspertët tanë mund të bashkëpunojnë për të ndihmuar Shqipërinë në përgatitjen për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Sekretariati i SPI-së ka qenë një organizues i shkëlqyer. Grupet e Punës gjithashtu, ka bërë një punë mjaft cilësore. Kjo më jep shpresën, se ne po zhvillojmë aftësi për realizimin e punëve, të cilat më parë kryeshin përgjithësisht nga ekspertë ndërkombëtarë", ka theksuar Ibrahimi. Ndërsa për kryetarin e sapozgjedhur të shoqatës shqiptare të bankave Catalano, SPI Albania ofron dy përparësi unike, të cilat një shoqatë nuk i gëzon. "Së pari, ajo gëzon kredibilitet për arritjen e një konsensusi të gjerë me autoritetet, lidhur me propozime për reforma prioritare, mbi të cilat komuniteti ynë duhet të punojë. Së dyti, ajo gëzon aftësitë organizative për mobilizimin e shumë ekspertëve nga Banka e Shqipërisë dhe nga ministri të tjera, përvoja dhe gjykimi i të cilëve janë mjaft të rëndësishme për përgatitjen e propozimeve të vlefshme për reforma, me qëllim krijimin e një klime më të mirë biznesi", ka thënë ai.

Ministri Olldashi dhe ai kosovar Limaj inspektojnë punimet në Kalimash

**Durrës-Prishtinë, pala kosovare gati të nisë rrugën**

FABIOLA ÇELA

Punimet në segmentin rrugor Durrës-Kukës kanë përfunduar në masën 75 për qind. Ndërsa për sa i përket tunelit, që është edhe pjesa më e vështirë e këtij projekti, ka mbeur vetëm 600 metra pa përfunduar.



Ministri Olldashi

Ministri i Punëve Publike dhe homologu u tij kosovar Fatmir Limaj kanë inspektuar dhe punimet në rrugën Durrës-Kukës. Gjatë prononcimit të tij për media, ministri Olldashi ka garantuar edhe një herë se ky projekt do të përfundojë në qershor. "Rruga po progreson në termat kohorë të përcaktuar dhe kështu do të vazhdojë deri në muajin qershor. Kjo rrugë është një korridor shumë i rëndësishëm, si për Kosovën dhe Shqipërinë, ashtu dhe për rajonin", u shpreh Olldashi. Ndërkra ministri Limaj deklaroi se është qeveria e Kosovës ka në plan që të nisë ndërtimin e pjesës kosovare të rrugës, kostoja e së cilës vlerësohet të jetë deri në një miliard euro. "Rruga është e një rëndësie të madhe për Shqipërinë dhe Kosovën", u shpreh Limaj.

**RRUGA**  
Kompania "Bechtel-Enka" po punon në të gjithë gjatësinë e rrugës, 60 km. Puna vazhdon në të 27 urat, prej të cilave, në 16 ura ato kanë përfunduar. Në dhjetor 2008 përfundoi edhe ura më e lartë në segmentin e tretë prej 80 m, e quajtur ura 88 në krahun verior të tunelit. Kompania "Bechtel-Enka" po punon njëkohësisht në të dy hyrjet e tunelit, veri dhe jug paralelisht. Në këtë aks punojnë mbi 3500 punonjës dhe për të arritur një progres të tillë punimsh po përdoren rreth 1300 makineri të tipëve të ndryshme.  
Segmenti Rrëshen-Kalimash është pjesë e autostradës Durrës-Morinë, 170 km e gjatë, e cila lidh bregun e Adriatikut me ku-

firin e Kosovës dhe rajonin. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor është veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, sepse lidh tregjet e Evropës Juglindore me rrugët kryesore ndërkombëtare detare, nëpërmjet portit të Adriatikut në Durrës.

**PORTI**

Po dje, dy ministrat Olldashi dhe Limaj kanë vizituar edhe portin e Shëngjinit, i cili me përfundimin e rrugës Durrës-Kukës merr një rol parësor dhe strategjik, duke i ofruar Kosovës dalje në det. Vetëm dy ditë më parë, te ministri të qeverisë së Kosovës i paraqitën Kryeministrit Berisha vendimin e qeverisë së Kosovës për të hapur bisedimet rreth portit të

**75** PËR QIND e punimeve të rrugës Durrës-Kukës kanë përfunduar. Sipas zyrtarëve të lartë të qeverisë, ndërtimi i këtij segmenti rrugor do të përfundojë në muajin qershor.

Shëngjinit, për të cilin qeveria e Kosovës ka ngritur një grup ndërmësor. "Përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës ndodheshin në Shqipëri për t'i dorëzuar Kryeministrit Berisha letërën e Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, për krijimin e një grupi ndërmësor të përbashkët për të shqyrtuar procedurat për ndërtimin e një porti në Shqipëri, që do të ketë destinacion Kosovën. Kryeministri Berisha u shpreh se Shqipëria është plotësisht e gatshme që Kosovës t'i akordohet një port për të plotësuar nevojat e saj", thuhet në njoftimin për shtyp të Këshillit të Ministrave, lidhur me takimin e Kryeministrit Berisha me ministrat Fatmir Limaj, Ahmet Shala dhe Lutfi Zhargu.

**Austriakët krijojnë kompaninë "Energji Ashta shpk"**

**Verbund themelon kompaninë për ndërtimin me koncesion të HEC "Ashta"**

Një tjetër HEC do të ndërtohet në kaskadën e lumit Drin. Kompania austriake Verbund së shpejti pritet të nisë punën për ndërtimin e hidrocentralit të Ashtës. Aktualisht kjo kompani ka shpallur themelimin e projekt kompanisë "Energji Ashta shpk". Kjo kompani ka përgjegjësi planifikimin, ndërtimin dhe drejtimin e HEC-in e Ashtës në afërsi të Shkodrës. Në shtator 2008 Verbund fitoi koncesionin për ndërtim dhe udhëheqjen e funksionimit në 35 vjet të hidrocentralit që do të ndërtohet në Ashtë. Ky projekt do të ketë ndikim të ndjeshëm në gjendjen energjetike në Sh-



qipëri. Gjatë vënies në punë, HEC-i i Ashtës do të furnizojë me energji elektrike më shumë se 100.000 ekonomi shtëpiake shqiptare. HEC-i i Ashtës është i fundit në ujëvarën e lumit Drin dhe është i vendosur nën rrjedhën ujore të stacionit grumbullues të energjisë elektrike të

Vaut të Dejës. Verbund është kompania kryesuese e prodhimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, si dhe një nga prodhuesit më të mirë nëpërmjet fuqisë ujore, duke u renditur në kompanitë më të ardhura më të mira në Evropë. Në 2007-ën Verbund mbyllti një xhiro vjetore me më shumë se 3 miliardë euro dhe 2,500 punonjës. Në Austri, Verbund-i vepron në fushat e prodhimit, transmetimit, tregtisë dhe shitjes. Jashtë Austrisë kompania është aktive në prodhim dhe tregti në më shumë se 20 vende dhe po zgjeron në mënyrë të vazhdueshme rolin e saj si lojtar ndërkombëtar.

**NJOFTIM PUNESIMI**

**Kerkohe agjente femra marketingu dhe promocioni prane kompanise "Birra Korca"**

**Kerkesat:**

- Te kete patente per drejtimin e automjetit
- Te kete arsimin e larte (preferohet dega ekonomik per Marketing)
- Te kete aftesi te mira komunikuese
- Te jete sistematike dhe e afte te punoj ne grup.

**Pergjegjesite kryesore:**

- Te studioje dhe te analizoje tregun e birres
- Te plotesoje objektivat per zgerimin e tregut
- Te punoje per promovimin e produktit
- Te punoje per lidhjen e imazhit te birres ne sherbim te klientit dhe konsumatorit final

Nga aplikanti kerkohe CV e detajuar dhe dy referenca n.q.s ka eksperience pune Cv-te mund te dergohe ne kete adrese e-mail: [sales@birrakorca.com.al](mailto:sales@birrakorca.com.al)

**Nr telefoni:** 068 60 24 018  
068 20 70 713